

**LEDIA DUSHKU**

**SHQIPËRIA DHE GREQIA NË RRJEDHËN  
E LUFTËS SË PARË BALLKANIKE  
TETOR-NËNTOR 1912**

**1. Greqia mbështet planin serb**

Shpërthimi i Luftës Ballkanike në tetor të vitit 1912 dhe ecuria e saj në favor të shteteve ballkanike, shtroi para tyre për diskutim çështjen e ndarjes së zotërimeve territoriale të Perandorisë Osmane. Shumë pyetje kërkonin përgjigje. Çdo të bëhej me zotërimet osmane në Ballkan? Si do të merreshin vesh shtetet ballkanike mes tyre? Do të ekzistonte Shqipëria, apo territoret shqiptare do të ndaheshin mes fitimtarëve?

Që në fund të tetorit të 1912, shtetet ballkanike filluan diskutimet mes tyre për të ndarë zotërimet osmane, pjesë e të cilave ishin edhe territoret shqiptare. Serbia ishte e qartë dhe e prerë në qëndrimin e saj. Ajo ishte kundër krijimit të një shteti shqiptar, qoftë ky edhe autonom. Serbia kërkonte dalje në detin Adriatik, të cilën e konsideronte jetësore për ekzistencën e saj dhe pranonte t'u jepte shqiptarëve që do të ishin pjesë e shtetit serb, një autonomi arsimore-kulturore<sup>1</sup>. Duke dashur të shmangte një herë e përgjithmonë ndërhyrjen e Austro-Hungarisë në bregdetin Adriatik, ajo pretendonte t'i ndante territoret shqiptar mes saj, Malit të Zi dhe Greqisë. Vija kufitare me Greqinë, duhet të fillonte në veri të Vlorës, afër Semanit dhe të dilte në Manastir midis Liqenit të Ohrit dhe të Prespës<sup>2</sup>. Duke ndjekur një vijë të tillë, Greqia duhet të zotëronte veç të tjerash edhe Vlorën e Sazanin.

Mbretëria Greke nuk ishte shumë e qartë në lidhje me të ardhmen politike të Shqipërisë. Në parim ajo nuk ishte kundër një shteti autonom shqiptar, por kufijtë jugorë duhet pa diskutim të kënaqnin pretendimet e

---

<sup>1</sup> Xheladin Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe, 1912-1918*, Prishtinë, 1990, f. 91; Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2006, f. 312.

<sup>2</sup> Zekeria Cana, *vep. e përm.*, f. 316.

saj në viset jugore shqiptare<sup>3</sup>. Në mbështetje të këtij qëndrimi ajo mendonte të krijohet një Shqipëri autonome me kufij të kufizuar vetëm në sanxhakun e Elbasanit dhe të Beratit. Katandisja e territoreve shqiptare në të atillë shtet që nuk kishte shanse të mbijetonte, ishte njësoj sikur të mos ekzistonte. Ai do të ishte kështu, i varur prej fqinjëve, duke qenë kështu një pre e lehtë dhe e parrezikshme për synimet e tyre.

Greqia e përliqte qëndrimin e saj për Shqipërinë autonome, me frikën e ndërhyrjes së Austro-Hungarisë<sup>4</sup>. Në fakt, Austro-Hungaria e konsideronte rajonin e Ballkanit si zonën e saj të influencës dhe të vetmen ku mund të matej me Fuqitë e tjera të Mëdha<sup>5</sup>. Në kushtet e reja që krijoi shpërthimi dhe ecuria e Luftës së Parë Ballkanike, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë u zhvilluan një sërë takimesh për të përshtatur qëndrimin ndaj Ballkanit. Pas diskutimesh u përcaktua se një nga prioritetet e politikës vjeneze ishte krijimi i një shteti autonom ose të pavarur shqiptar<sup>6</sup>. Krijimi i një Shqipërie autonome ose nëse kishte mundësi të pavarur drejtohej direkt kundër Serbisë, e cila kërkonte dalje në detin Adriatik në mënyrë të pavarur nga Mali i Zi. Për sa kohë Vjena dhe Roma nuk kishin deklaruar një qëndrim të përbashkët për të ardhmen e territoreve shqiptare, qëndrimi i Austro-Hungarisë, prekte edhe interesat e Italisë, e cila dëshironte ta bënte detin Adriatik një sferë italiane të influencës. Ambasadori francez në Vjenë, pretendonte se kishte përpjekje nga “Austro-Hungaria për t’i bërë shtetet ballkanike të sillëshin në orbitën e Aleancës Trepalëshe<sup>7</sup>”. Në një situatë të tillë, mbështetja që Greqia mund t’i jepte krijimit të një shteti shqiptar, shkonte me linjën e Vjenës. Këtë ajo mund ta përdorte si një gur të fortë për të shmangur një ndërhyrje italiane në territoret e pretenduara prej saj.

<sup>3</sup> *Haus-Hof und Staatsarchiv, Wien, Politisches Archiv* (më tej: *HHSPA*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj, 22-23-2364. Raport dite mbi vizitën e ambasadorit të Greqisë në Vjenë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, dt, 9 nëntor 1912.

<sup>4</sup> Zef Prela, *Problemi shqiptar dhe politika Austro-Hungareze, 1897-1912*, në: “Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, Tiranë, 1962, f. 190; Zekeria Cana, *vep. e përm.*, f. 316.

<sup>5</sup> Karl Kase, *The Balkan wars, 1912-13: an Austrian perspective*, në “Crossroads of European histories”, Council of Europe, December 2006, f. 131.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 135; Stefanaq Pollo, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, në “Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, f. 85.

<sup>7</sup> Raymond Poincaré, *Lufta e Parë dhe e dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913)*, Logos, Prishtinë, 2006, f. 288.

Por, Greqia ishte anëtare e Aleancës së shteteve Ballkanike dhe si e tillë kishte detyrime ndaj saj. Për të siguruar marrëdhënie të mira dhe të qëndrueshme me Serbinë dhe një marrëveshje kufitare me Bullgarinë që kënaqte pretendimet e saj, Greqia ishte e gatshme ta sakrifikonte ekzistencën e Shqipërisë. Shqetësim për qeverinë greke, duhej të ishte fakti se nëse ajo nuk e mbështeste Serbinë për daljen në det, kishte mundësi që Serbia ta siguronte atë, nëpërmjet një aleance me Italinë. Në kushtet e takimeve të shpeshta italo-serbe në fund të tetorit dhe fillim të nëntorit, aleanca serbo-italiane nuk dukej e pamundur<sup>8</sup>. Realizimi i saj ishte një hap drejt legjitimitetit të influencës italiane në viset jugore shqiptare dhe kontrollit të ngushticës së Otrantos prej saj. Një gjë e tillë, sigurisht që binte ndesh me interesat greke.

Duke dashur ta shmangte këtë, në fillim të nëntorit, ministri i jashtëm grek, kërkoi që aleatët ballkanikë, të merreshin vesh sa më shpejt me njëri-tjetrin për saktësimin e pretendimeve territoriale. Greqia mendonte se një marrëveshje e përbashkët ballkanike për kufijtë, do të ishte më e suksesshme, nëse secila palë saktësonte pretendimet e saj. Shtetet aleate, duhet t'ua paraqisnin bashkërisht pretendimet e tyre Perandorisë Osmane. Të ngazëllyera nga fitoret e arritura, ata natyrisht nuk kërkonin ndërmjetësimin e Fuqive të Mëdha<sup>9</sup>. Në këtë mënyrë, do të ishte më e lehtë për ta, të përcaktonin dallime, të gjenin një ekuilibër mes tyre, si dhe të mbronin fitoret e luftës përballë Fuqive të Mëdha.

Shqetësim i Greqisë ishte edhe mospajtimi që ajo kishte me Bullgarinë, në lidhje me kufirin mes tyre. Ajo i konsideronte pretendimet bullgare të tepruara<sup>10</sup>. Shqetësimi sa vinte e shtohet edhe për faktin se Sofja nuk i kishte dhënë përgjigje përpjekjeve greke për një marrëveshje të përbashkët ballkanike për pretendimet territoriale. Dukej se Bullgaria nuk kishte ndërmend t'i lëshonte pe Greqisë, për Trakinë. Kishte gjasa që Serbia, nga ana tjetër, nëse nuk do të siguronte mbështetje për daljen në detin Adriatik, të kërkonte kompensim në atë territor.

Në një situatë të tillë, Athina iu përgjigj pozitivisht ftesës së Beogradit për një marrëveshje të përbashkët mes tyre. Takimet mes palëve filluan në fund të tetorit dhe vazhduan edhe ditët e para të nëntorit

<sup>8</sup> Në lidhje me takimet serbo-italiane shih: Zekeria Cana, *vep e përm.*, f. 305-312.

<sup>9</sup> Raymond Poincare, *vep e përm.*, f. 286.

<sup>10</sup> Ch. Fragistas, *The Balkan wars, their meaning in the history of Greece*, në "Ballkan Studies", Vol. 3, Nr. 2, Thessaloniki, 1962, f. 252-253.

të vitit 1912. Në to, Greqia i kërkoi Serbisë rolin e ndërmjetësit në arritjen e një marrëveshjeje me Bullgarinë për kufirin mes tyre, duke e justifikuar ndërmjetësinë me jetëgjatësinë e Aleancës Ballkanike. Kompromisi që ajo bënte lidhej direkt me të ardhmen politike të territoreve shqiptare. Qeveria greke pranoi t'i ndante territoret shqiptare mes saj dhe Serbisë dhe të mbështeste pretendimet serbe për daljen në det nga Lezha në Durrës<sup>11</sup>. Mbështetja do të bëhej jo vetëm në rrugë diplomatike por edhe me forcë të armatosur<sup>12</sup>. Duke dashur ta mbante ende nën presion Serbinë, për të siguruar mbështetjen e saj në arritjen e një marrëveshjeje kufitare me Bullgarinë, Greqia nuk pranoi të deklaronte mbështetjen e plotë ndaj Serbinë për kufijtë mes tyre, pasi sikurse u shpreh, nuk ishte e gatshme të dilte hapur kundër pretendimeve të Austro-Hungarisë<sup>13</sup>.

Në mbështetje të qëndrimeve të mësipërme, më 8 nëntor të 1912 në takimim e ministrit të jashtëm grek, Koromilas me përfaqësuesin e Ministrisë së Jashtme të Serbisë, ai deklaroi se me vendosjen e kufirit të përbashkët serbo-grek, mendimi i saj për krijimin e një shteti autonom shqiptar, do të sakrifikohej<sup>14</sup>. Këtë qëndrim ministri e përforcoi edhe në takimim që pati me homologut të tij rus. Tanimë, formimi i Shqipërisë autonome konsiderohej prej Greqisë të ishte shumë i rrezikshëm për Aleancën Ballkanike dhe i favorshëm për ndërhyrjen e Austro-Hungarisë në Ballkan<sup>15</sup>.

Greqia filloi mbështetjen diplomatike në përmbushje të premtimit që i kishte dhënë Serbisë. Koromilasi zhvilloi takime të njëpasnjëshme me ambasadorin austriak në Athinë. Meqenëse dalja e Serbisë në det dhe çështja shqiptare kishin lidhje me interesat e Greqisë, ai deklaroi që qeveria e tij kishte vendosur të mbështeste homologen e saj serbe në çështjet e mësipërme. Ai mbështeti copëtimin e territoreve shqiptare mes shteteve aleate, madje me shumë guxim deklaroi se një veprim i tillë

<sup>11</sup> L.S. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, Holt, Rinehart and Winston, 1958, f. 510.

<sup>12</sup> Zekeria Cana, *vep e përm.*, f. 317.

<sup>13</sup> HHSA në AIH, Vj, 22-23-2354. Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 8 nëntor 1912. Mbi takimim e tij me Koromilasin.

<sup>14</sup> Z. Cana, *vep e përm.*, f. 316.

<sup>15</sup> Zef Prela, *Problemi shqiptar dhe politika Austro-Hungareze, 1897-1912*, në "Mbi Lëvizjen.....", *vep e përm.*, f. 190.

ishte edhe në interes të politikës së Austro-Hungarisë, sepse vetëm kështu do të zhdukeshin një herë e përgjithmonë ndërlikimet në Ballkan<sup>16</sup>.

Në një situatë të tillë, që sa vinte e bëhej më e ndërlikuar e shqetësuese, më 17 nëntor të 1912, ministri i jashtëm austriak, Bertoldi iu drejtua homologut të tij italian lidhur me rregullimin e problemit shqiptar. Ai mendonte se duhej të sigurohej një Shqipëri “viable”. Ajo mund të ishte autonome ose e pavarur dhe duhej të përfshinte në kufijtë e saj të gjithë rajonin që banohej nga shqiptarë. Mbështetur në një logjikë të tillë, Austro-Hungaria nuk pranonte daljen e Serbisë në det, ndërsa në lidhje me kufijtë e jugut, pranonte t’i linte Greqisë territorin në jug të lumit Kalamas. Roma, në dallim nga Vjena, ishte më skeptike, veçanërisht për sa i përket pjekurisë të shqiptarëve për të siguruar dhe mbrojtur autonominë. Ministri i jashtëm italian, Xhuliano e cilësonte Shqipërinë si vend të vobektë, primitiv që çdo shtet fqinj “donte ta qethte nga të katër anët”<sup>17</sup>. Gjithashtu, ai ishte shumë dyshues që Greqia të kënaqej me kufirin deri në Kalamasin, sepse aspiratat e saj shkonin shumë më në veri<sup>18</sup>. Megjithatë, Italia e kishte kuptuar se fati i mëtejshëm i Shqipërisë kishte rëndësi të veçantë edhe për të. Me të lidhej jo vetëm rivaliteti me Austro-Hungarinë për supremacinë në Adriatik, por edhe gjithë politika ekspansioniste e saj në drejtim të Gadishullit të Ballkanit<sup>19</sup>. Gjithashtu, qarqet italiane nuk mund të ishin të shkujdesura përballë forcimit tej mase të Serbisë e të Greqisë, të cilat kishin shfaqur pretendimet e tyre aneksioniste edhe ndaj territoreve shqiptare. Për të evituar çdo surprizë nga ana e Mbretërisë Austro-Hungareze, Italia mbështeti qëndrimin e Vjenës për problemin shqiptar, kundër pretendimeve serbe e greke dhe ndërhyrjes së Fuqive të Antantës. Më 21 nëntor të 1912, San Xhuliano njoftoi se ishte dakord me propozimin e

<sup>16</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj. 22-24-2414. Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 14 nëntor 1912. Mbi takimin e tij me Koromilasin; *HHSA* në *AIH*, Vj, 22-24-2423. Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 15 nëntor 1912. Mbi takimin e tij me Koromilasin.

<sup>17</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj, 22-11-1163. Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Jashtme, Romë, 19 nëntor 1912. Mbi takimin me ministrin e jashtëm italian, San Xhuliano.

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Albin, Tiranë, 2007, f. 85.

Bertoldit. Nisën kështu diskutimet për ripërtëritje e Paktit Trepalësh, i cili u deklarua në fillim të dhjetorit të 1913. Pakti i sigurate Italisë përkrahjen e Austro-Hungarisë për të bllokuar depërtimin ndikimeve të tjera në Adriatik dhe e detyronte këtë të fundit të mos ndërmerre asgjë në Ballkan, pa u marrë vesh me Italinë<sup>20</sup>. Në këtë mënyrë të dyja fuqitë ndanin ndikimin e tyre edhe në Shqipëri.

Arritja e marrëveshjes mes dy Fuqive i nxiti edhe më shumë shtetet ballkanike, të përshpejtonin veprimet ushtarake në territoret shqiptare. Ata pretendonin t'i pushtonin ato, sa më shpejt të ishte e mundur pa u arritur marrëveshja e armëpushimit me Perandorinë Osmane dhe pa u mbledhur Konferenca e Ambasadorëve në Londër.

## **2. Viset jugore shqiptare përballë sulmit të ushtrisë greke. Pushtimi i Himarës**

Në kuadrin e përgjithshëm të operacioneve luftarake, territoret shqiptare u konsideruan nga shtetet ballkanike si territore te Perandorisë Osmane. Greqia nuk bëri përjashtim. Qëllimi kryesor i operacioneve greke ishte pushtimi i tyre. Nëpërmjet tij synohej bashkimi i gjithë territoreve të pushtuara me Mbretërinë Greke. Në rastin më të keq, nëse kjo nuk do të arrihej, këto territore mund të përdroreshin si mjet këmbimi për të aneksuar territoret të cilat Greqia i konsideronte të patolerueshme. Ato ishin pjesë përbërëse e rivendikimeve greke të mbështetur në Megali –Ide dhe preknin veçanërisht vijën Himarë-Korçë.

Që më 18 tetor të vitit 1912, sapo Greqia u bë pjesëmarrëse në Luftën e Parë Ballkanike, vendosi bllokadën detare. Ajo nënkuptonte bllokimin e të gjithë porteve osmane, çka do të thoshte asnjë qarkullim i anijeve osmane në brigjet detare që kontrolloheshin nga flota greke. Sigurisht që bllokada preku edhe bregdetin e Jonit. Fillimisht, ajo u vendos në vijën bregdetare që fillonte nga gjiri i Artës e vazhdonte deri në jug të Igumenicës. Vendosja e bllokadës i parapriu marrjes së qyteteve-porte nga flota greke dhe lehtësoi operacionet ushtarake në tokë. Në ditët e para të nëntorit, trupat greke morën Prevezën dhe bombarduan Igumenicën e Sarandën. Më 4 nëntor 1912, bllokada greke u shtri deri në Vlorë. Vendosja e bllokadës deri në Vlorë, të bën të mendosh se Greqia po përgatitej për të pushtuar edhe atë.

<sup>20</sup> *Po aty*, f. 85-86.

Çështja se ku do të shkonte marshimi i ushtrisë greke në territorin shqiptar, u shtrua në tavolinën e diskutimeve qeveritare që pas marrjes së Prevezës. Marrëveshja e arritur me Serbinë dhe mbështetja që Greqia kishte vendosur t'i jepte asaj, duket se përligjinin vendosjen e bllokadës greke në Vlorë, duke synuar me pas edhe marrjen e saj. Por, menjëherë, më 5 nëntor 1912 në dyert e Ministrisë së Jashtme Greke, arriti një notë e qeverisë italiane dhe një ditë më pas një njoftim i Ministrisë së Jashtme Austro-Hungareze<sup>21</sup>. Të dy shtetet shpreheshin hapur se bllokimi i bregdetit osman deri në Vlorë nuk mund të justifikohet kurrsesi vetëm me arsye ushtarake. Bllokimi i Vlorës prekte direkt tregtinë austriake dhe interesat strategjike italiane. Nëse qeveria greke do të vazhdonte të këmbëngulte në një veprim të tillë atëherë, "opinionit politik në Austri dhe Itali do të influenconte në dëm të interesave greke"<sup>22</sup>.

Në një situatë të tillë, qeveria greke mori vendim për të pushtuar vetëm Himarën, por duke mos e mbyllur çështjen e Vlorës. Marshimi për më tej do të varej nga qëndrimi që do të mbante qeveria italiane ndaj zbarkimit në bregdetin himarjot. Në këtë mënyrë pushtimi i Himarës dukej se kishte të bënte më shumë "me politikën e jashtme" sesa me nevojat ushtarake. Për këtë u gjet e rrugës që marshimin të mos e bënte ushtria e rregullt greke, por ta bënin vendasit, në mënyrë që qeveria greke të mos kishte të bënte direkt, veçanërisht me qëndrimin e Romës.

Zbarkimi në zonën e Himarës filloi me pëlqimin qeverisë dhe të Komandës së Përgjithshme të ushtrisë greke<sup>23</sup>. Në krye të forcave ushtarake qëndronte i vetëquajturi "Prijës i Himarës", Spiro Spiromilo<sup>24</sup>. Ai ishte lindur në Himarë, por ishte rritur dhe jetonte në Greqi, ku dhe kishte qenë oficer në degën e xhandarmërisë. I kishte shërbyer më devotshmëri "çështjes greke". Në periudhën e veprimtarisë së çetave në Maqedoni, ishte nga të paktët që ishte regjistruar vullnetar në çetat greke që vepronin në krahinën e Kosturit. Në trupën e tij kishte disa vullnetarë himarjotë që banonin në Greqi, disa ushtarë grekë dhe vendas të rekrutuar

<sup>21</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj, 22-18-1839. Telegram i Ministrisë së Jashtme të Italisë për ambasadën e saj në Athinë, Romë, 5 nëntor 1912; *HHSA* në *AIH*, Vj, 22-23-2343. Njoftim i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për ambasadën në Athinë, Vjenë, 6 nëntor 1912.

<sup>22</sup> *Po aty*.

<sup>23</sup> *AIH*, A-IV-213, Spiromilo Milto, *Shqipëria dhe Greqia*, Kajro, 1942, f. 30

<sup>24</sup> *Arkivi Qendror i Shtetit (më tej AQSH)*, Fondi 56, dos. 65, fl. 6; *Eqrem Vlora, Kujtime (1885-1912)*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 200, f. 309.

prej tij.<sup>25</sup> Himara ishte një krahinë larg çdo kontakti me armatën e Epirit. Në ndihmë të Spiromilos, qeveria greke kishte vënë në dispozicion edhe dy luftanije të vogla, të cilat shoqëronin vaporin e transportit “Hrisalia”, brenda të cilit ndodheshin forcat ushtarake që vinin nga Athina. Më 18 nëntor 1912, forcat e para dolën në Spille. Shpejt u pushtua Himara qendër, Qiparoi, Kudhësi, Piluri, Vunoi, Dhërmiu e Palasa. Në zonat e pushtuara menjëherë u ngrit flamuri, i cili çuditërisht nuk ishte grek. Flamuri përbëhej nga ngjyrat e flamurit grek me 7 yje në mes, që simbolizonin shtatë fshatrat e krahinës së Himarës. Sipas studiuesit Timo Dilo, kryerja e aksionit nga vendasit bëhej edhe për t’i paraprirë zhvillimeve të mëvonshme dhe qëndrimit të ndërkombëtarëve. Në rast se Fuqitë e Mëdha do të vendosnin që krahina e Himarës t’i mbetej Shqipërisë, atëherë asaj duhej t’i siguroheshin privilegjet që kishte gëzuar në periudhën otomane. Për qeverinë e Athinës, privilegjet kishin më shumë mundësi të siguroheshin nëse ushtria e rregullt greke qëndronte larg pushtimit të krahinës. Pushtimi nga vendasit ishte kështu në mbështetje të krijimit të një administrate autonome që do të vazhdonte t’i përforconte privilegjet e gëzuara, duke kërkuar edhe respektimin e saj nga qeveria shqiptare. Brenda këtij kuadri duhet konsideruar edhe porosia që i dha Spiromilo trupave të tij për të pushtuar vetëm krahinat që gëzonin privilegje nga Perandoria Otomane dhe për të ngritur flamurin “himarjot”<sup>26</sup>.

Pasi Spiromilo u vendos në Himarë, anijet greke bombarduan Vlorën<sup>27</sup>. Çështja e pushtimit të Vlorës dukej se kishte dalë sërish për diskutim në qeverinë greke. Besoj se një gjë e tillë lidhej me dy arsye. Së pari me pasigurinë që ndjente Spiromilo në Himarë. Ai i raportonte qeverisë greke se nuk ishte i sigurt në tokën që kishte okupuar, për shkak të sulmeve që i vinin nga shqiptarët. Në fakt shqiptarët nën drejtimin e Eqrem Vlorës, i emëruar nga komanda e ushtrisë osmane, komandant i trupave mbrojtëse territoriale, ishin shqetësuar i vazhdueshëm për forcat e Spiromilos<sup>28</sup>. Për t’i përballuar ato, ai kërkonte pushtimin e Vlorës. Në

<sup>25</sup> AIH, A-IV-330, Timo Dilo, *Invazionet greke në Shqipërinë e Jugut*, fl. 4.

<sup>26</sup> *Po aty*.

<sup>27</sup> Lef Nosi, *Dokumente Historike 1912-1918*, Instituti i Historisë, Tiranë, 2007, f. 52-53.

<sup>28</sup> Eqrem Vlora, *vep e përm.*, f. 310-312.

pamundësi ta bënte vetë, sepse i mungonin forcat, Spiromilo kërkonte që aksionin ta merrte përsipër vetë qeveria greke.<sup>29</sup>

Arsyeja e dytë mendoj se kishte të bënte me aksionin grek për marrjen e ishullit të Sazanit. Disa ditë mbas pushtimit të Himarës, një kompani marinarësh grekë zbriti në ishull. Në dallim nga Himara, aksioni në Sazan u mor përsipër nga flota greke, e cila e legjitimoi aksionin me vendosjen e flamurit grek atje. Rëndësia strategjike e Sazanit ishte e pakundërshtueshme. Ai së bashku me gjirin e Vlorës zotëronte ngushticën e Otranton. Por, vlera e Sazanit ishte e të tillë vetëm nëse zotëroje edhe Vlorën. Vlera e tij pa Vlorën ishte relative. Në një situatë të tillë, përpara qeverisë greke shtrohej çështja e zotërimit të Vlorës<sup>30</sup>. Duke i zotëruar të dyja, ajo do ta kishte më të lehtë të bënte presion tek Fuqive të Mëdha. Greqia e kishte të vështirë ta mbante Sazanit. Për vetë rëndësinë e tij strategjike, Fuqitë e interesuara direkt, por edhe Fuqitë e tjera të Mëdha, për interesin e përbashkët të Evropës, nuk do të lejonin që Sazani të ishte në duart e një fuqie detare, qoftë kjo edhe e dorës së dytë siç ishte Greqia<sup>31</sup>.

Por, kryeministri grek, Venizellos mbeti i pavendosur në lidhje me sulmin për Vlorën. Fillimisht ai pranoi dhe ra dakord për të filluar përgatitjet, por disa ditë më pas ai u tërhoq. Vlora nuk cilësohej prej tij si qytet i cili përlligjte veprimet luftarake. Arsyeja lidhej me frikën që ai kishte nga Italia. Duke e konsideruar Italinë armikun më të madh të “racës greke”, ai mendonte se pushtimi i Vlorës prej Greqisë do t’i jepte shkas një sulmi italian. Në gjendjen e ndërlikuar në të cilën ndodhej Greqia, për shkak të ftohjes me Austro-Hungarinë dhe fërkimeve që kishte me Bullgarinë, Venizellosi nuk guxonte t’i shtonte vetes edhe armiqësinë e hapur me Italinë. Fakti që Italia kishte reaguar ndaj zbarkimit në bregdetin himarjot e bënte atë hezitues në hedhjen e një hapi të tillë. Megjithatë në takimet diplomatike, Greqia nuk hoqi dorë nga të kërkuarit e Vlorës. Koromilasi vazhdonte të këmbëngulte se “Vlora duhet t’i jepej medoemos Greqisë. Se kufiri i Greqisë në anë të veriut duhet të

<sup>29</sup> *AIH*, A-IV-213, Spiromilo Milto, *Shqipëria...*, vep e për. fl. 31.

<sup>30</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj. 22-18-1839. Fjala e kryeministrit grek, Venizellos në parlamentin grek, për çështjen e Sazanit.

<sup>31</sup> *Po aty*.

shkojë gjer në gji të Vlorës e në veri të Tepelenës dhe nëpër malet e Dangëllisë e të Panaritit duke përfshirë brenda edhe Voskopojën.”<sup>32</sup>

Tërheqja nga pushtimi i Vlorës, u zëvendësua me orientimin dhe më vonë me vendimin për të zbarkuar në Sarandë. Një veprim i tillë u lidh direkt me rëndësinë që kishte marrja e Janinën, cila ishte rrethuar nga ushtria greke më 8 nëntor 1912. Qyteti konsiderohej prej Venizellosit i një rëndësi të veçantë. Në dallim nga Vlora, ai duhej patjetër të merrej me luftë, në të kundërt Greqisë do t'i kundërshtohej zotërimi i qytetit nga Fuqitë e Trepalëshit. Qyteti pretendohet edhe nga shqiptarët të cilët ishin pjesë e ushtrisë osmane. Në pretendimet e tyre ata mbështeteshin, veçanërisht nga Austro-Hungaria. Në një situatë të tillë, marrja e Janinës me luftë, legjitimonte kërkesat greke për këtë qytet dhe lehtësonte veprimet e ushtrisë greke për një shtrirje më në veri. Kryeministri grek pretendonte se zbarkimi në Sarandë do t'i shërbente zotërimit nga ushtria greke të rrugës që lidhte Sarandën me Janinën. Kështu, grekët do të mund të bllokonin kështjellën e Janinës nga të katër anët, duke e pasur më të lehtë zotërimin e qytetit.<sup>33</sup> Ndërkohë që situata në terren ishte e tillë, shqiptarët po përgatiteshin për të reaguar.

### **3. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë dhe qëndrimi i Greqisë**

Kur Ismail Qemali u nis nga Stambolli për në Bukuresht, Lufta e Parë Ballkanike kishte hyrë në fazën e fundit. Ushtria osmane e thyer po mundohej më kot t'i bënte ballë sulmit të ushtrive ballkanike. Parimi i ruajtjes së status-quo-së, i pranuar nga Fuqitë e Mëdha pa plasur mirë lufta, ishte tashmë një kartë e djegur. Qëllimet “parimore” të fillimit të Luftës nga Aleatët Ballkanikë, ia kishin lënë vendin kontradiktave me tyre në lidhje me ndarjen e trashëgimisë osmane. Ecuria e luftës dhe përparimi i ushtrive ballkanike në viset shqiptare, jo vetëm shqetësoi, por edhe ndërgjegjësoi më shumë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Kishte ardhur koha për veprime konkrete dhe të shpejta, në mënyrë që Shqipëria të kishte të ardhme politike, në të kundërt, gjasat ishin që ajo të copëtohej mes shteteve fituese ballkanike. Merita e Ismail Qemalit dhe e mbështetësve të tij qëndronte pikërisht në vlerësimin e drejtë të një

<sup>32</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj. 22-25-2541, Telegram i Bertoldit për ambasadorin austriak në Romë, Vjenë, 27 nëntor 1912. Mbi takimin me Koromilasin.

<sup>33</sup> *AIH*, A-IV-213; Milto Spiromilo, *vep e përm.*, f. 33.

situatë të tillë, vlerësim që solli më pas reagimin në kohën dhe vendin e duhur për shpalljen e pavarësisë.

Po pse Ismail Qemali shkoi nga Stambolli në Bukuresht? Përveç arsyes që lidhet me mbështetjen që ai, me të drejtë, mendonte se do të gjente tek shqiptarët e kolonisë së Bukureshtit, mendoj se ka edhe një arsye të dytë. Ajo mendoj se lidhet direkt me planin që Ismail Qemali pretendonte të realizonte. Lufta Ballkanike sigurisht që do të sillte një ri përcaktim të kufijve në Ballkan. Sipas tij, zgjerimi i frontit sllav ishte evident. Në një situatë të tillë, Rumania, Shqipëria dhe Greqia duhej të ishin pjesë e frontit të dytë në Ballkan. Kështu, së afërmi Ismail Qemali mendonte se Ballkani do të ndahej në dy kampe: nga njëra anë vendet sllave Serbia, Bullgaria dhe Mali i Zi nga ana tjetër Rumani, Shqipëria dhe Greqia. Vetëm kështu, ai mendonte se do të mund të arrihej një lloj ekuilibri në Ballkan. Dëshira për vendosjen e një ekuilibri të tillë ishte sipas tij, një nga arsyet pse Austro-Hungaria ishte aq e vendosur për të ruajtur pavarësinë e Shqipërisë<sup>34</sup>. Për jetësimin e një ekuilibri të tillë, krijimi i Shqipërisë ishte domosdoshmëri dhe ai nuk duhej mbështetur vetëm nga Austro-Hungaria dhe Fuqitë e tjera të Mëdha, por të paktën edhe nga Rumania dhe Greqia.

Menjëherë sapo mbërriti në Bukuresht, Ismail Qemali u takua me ministrin e jashtëm rumun, Take Ionesku, i cili e siguroi për mbështetjen që Rumania do t'i jepte çështjes shqiptare<sup>35</sup>. Ndër të tjera ky interes lidhej edhe me popullsinë vllahe, të cilën ajo pretendonte ta shkëpuste nga ndikimi grek, duke e bërë pjesë të shtetit të ardhshëm shqiptar<sup>36</sup>. Ismail Qemalit i mbetej për të konfirmuar mbështetjen për çështjen shqiptare nga Fuqitë e Trepalëshit dhe Greqia.

Javën e parë të nëntorit, Ismail Qemali i shoqëruar nga Luigj Gurakuqi e Kristo Meksi, la Bukureshtin dhe iu drejtua Vjenës, ku me të drejtë mendohej se do të gjenin mbështetje për të ardhmen e Shqipërisë. Në takimet që Ismail Qemali zhvilloi me përfaqësuesit austriakë e italianë, u bind se kishte ardhur koha për ta lënë mënjane autonominë dhe

---

<sup>34</sup> *British Documents on the Origins of the War, 1898-1914*, G.P. Gooch and H. Temperley, London, 1926-1930, Vol. 9. Pjesa II. Raport i ambasadorit anglez në Vjenë për ministrin e jashtëm anglez, Grey, Vjenë, 10 nëntor 1912. Mbi takimin me Ismail Qemalin.

<sup>35</sup> *AQSh*, Fondi 20, dos. 12, fl. 9. Dhimitër Beratti për shpalljen e pavarësisë.

<sup>36</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj, 22-7-729. Telegram i ambasadorit austriak në Bukuresht për Ministrinë e Jashtme, Bukuresht, 22 nëntor 1912.

për të kaluar drejt pavarësisë. Pasi arriti të sigurojë mbështetjen e tyre, mbetej për të biseduar edhe me qeverinë greke. Nëse ajo mbështeste pavarësinë e Shqipërisë, rruga për diskutime të mëtejshme me Greqinë mbetej e hapur.

Ashtu sikurse kishte ndodhur edhe në momente të tjera të rëndësishme për shqiptarët, Ismail Qemali nuk kishte hezitur të kërkonte mbështetjen e Greqisë zyrtare<sup>37</sup>. Ai vazhdonte të mendonte se qeveria greke përkrahte luftën e popullit shqiptar dhe të besonte se ajo do të mbështeste interesat e përbashkëta të Greqisë dhe të Shqipërisë.<sup>38</sup> Në fakt, Mbretëria Greke ishte në dijeni të lëvizjeve të Ismail Qemalit. Që më 6 nëntor të 1912, fill pas mbledhjes që Ismail Qemali bëri me përfaqësues të kolonisë shqiptare të Bukureshtit, ambasadori grek atje kishte njoftuar Ministrinë e Jashtme mbi qëllimin e Ismail Qemalit për të mbledhur në Vlorë, anëtarët e komiteteve brenda dhe jashtë Shqipërisë në një kuvend kombëtar, i cili do të themelonte një qeveri të përkohshme në krye të së cilës do të ishte ai vetë. Në takimin e mesit të nëntorit të vitit 1912, Ismail Qemali vuri në dijeni ministrin e jashtëm grek, nëpërmjet ambasadorit grek në Vjenë, Streit, në lidhje me iniciativën e tij për shpalljen e pavarësisë dhe mbështetjen që kishte arritur të siguronte nga Austro-Hungaria<sup>39</sup>. Qeveria shqiptare që do të krijohet prej tij, nuk do të merrte pjesë në luftën ballkanike. Në atë kohë Greqia në dallim nga Serbia nuk kishte zbarkuar ende fuqishëm në territoret shqiptare. Ajo vetëm kishte rrethuar Janinën. Nëpërmjet një njoftimi të tillë, Ismail Qemali, duket se synonte nga njëra anë të ndalte okupimin e territorit shqiptar nga ushtria greke dhe nga ana tjetër të qetësonte disi Greqinë në lidhje me pjesëmarrjen shqiptarëve në luftë si pjesë e ushtrisë osmane. Duke qenë i vetëdijshëm në lidhje me problemet që mund të shkaktonte çështja e kufijve greko-shqiptare, ai i kërkoi Greqisë njohjen e qeverisë e tij me rezervën e një përcaktimi të kufijve në të ardhme. Në këmbim të predispozitave të mira që Greqia do të shprehte ndaj Shqipërisë, kjo e fundit merrte përsipër të mbështeste Greqinë kundër koalicionit sllav. Kjo mbështetje të lë të mendosh se Ismail Qemali vazhdonte ende të besonte

<sup>37</sup> Për më shumë shih: Ledia Dushku, *Ismail Qemali, Greqia dhe Kryengritja shqiptare e vitit 1912* në "Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shekullit XX", Tiranë, 2007, f. 91-105.

<sup>38</sup> Vasilis Kondis, *Shqipëria dhe Greqia në Shekullin e XX*, Selanik, 1997, f. 52.

<sup>39</sup> *Po aty*.

në planin e tij për krijimin e një fronti antisllav, duke dashur ta shkëpuste Greqinë nga koalicioni ekzistues ballkanik dhe ta bënte pjesë të tij.

Por a ishte e gatshme Greqia të mbështeste shqiptarët në një ndërmarrje të tillë, tepër të rëndësishme për të ardhmen politike të viseve të tyre?

Është e vërtetë që brenda zyrtarëve greke kishte një rrymë që mbante një qëndrim më realist ndaj shqiptarëve. Ajo promovohet nga drejtor i zyrës shqiptare në Ministrinë e Jashtme Greke njëkohësisht edhe këshilltar politik i komandantit të ushtrisë së Epirit, Sahturis<sup>40</sup>. Ai ishte njohës shumë i mirë i çështjes shqiptare, madje ishte edhe hartues i disa raporteve e studimeve të hollësishme në lidhje me të, për qeverinë greke. Duke mbështetur shqiptarët për shpalljen e pavarësisë në Vlorë, Sahturisi dhe përkrahësit e tij pretendonin të evitonin një pushtim të mundshëm të Vlorës prej Italisë dhe njëkohësisht t'i tregonin Evropës dhe pjesës dërrmuese të shqiptarëve qëllimet e mira që Greqia kishte duke ndihmuar në themelimin e shtetit shqiptar, por pa toleruar në çështjet kufitare. Nëpërmjet një ndihme të tillë, ajo rrymë mendonte të shkëpuste Shqipërinë nga ndikimi i Austro-Hungarisë dhe mbi të gjitha nga ai i Italisë. Por mbledhjet e qeverisë treguan se mendimet e Sahturisit ishin pakicë. Ato u mbështetën vetëm nga një ministër. Të gjithë të tjerët ishin kundër<sup>41</sup>.

Qëndrimin i qeverisë greke në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, e shpreh përgjigja e datës 16 nëntor 1912, që qeveria greke i transmetoi konsullit grek në Trieste, për Ismail Qemalin. "T'i thuash - i rekomandonte ai, - se nuk ke marrë ende orientime nga qeveria jote, por je i mendimit se qeveria greke do të duhej të njihte kufijtë e Shqipërisë"<sup>42</sup>. Në pamje të parë të duket se një tekst i tillë, mbështet shqetësimin që kishte edhe Ismail Qemali, pra atë të kufijve. Përgjigja të krijon përshtypjen se Greqinë nuk e shqetësonte akti i shpalljes së pavarësisë. Duket se kështu u kuptua ajo edhe nga Ismail Qemali. Në takimin që ai pati me konsullin austriak në Durrës, para se të nisej për në Vlorë, i konfirmoi atij premtimin që qeveria greke i kishte bërë atij për shpalljen e pavarësisë<sup>43</sup>.

<sup>40</sup> *AIH, A-IV-213*; Milto Spiromilo, *vep e përm.*, f. 32, 33.

<sup>41</sup> *Po aty*.

<sup>42</sup> Vasilis Kondis, *vep e përm.*, f. 52.

<sup>43</sup> *HNSA në AIH, Vj, 22-6-694*. Telegram i Rudneit për Bertoldin, Durrës, 23 nëntor 1912.

Duket se qeveria greke nuk ishte e gatshme të deklaronte hapur qëndrimin e saj. Jam e prirur të mendoj se pavarësisht simpativë reciproke që ajo dhe Ismail Qemali kishin pasur në vazhdimësi për njëritjetrin, qeveria greke nuk ishte e gatshme ta mbështeste pavarësinë e Shqipërisë për shkak të marrëdhënieve të afërta me Serbinë, qëndrimin që ajo kishte marrë tashmë në mbështetje të planit serb për copëtimin e territoreve shqiptare dhe frikës se shqiptarët do të kërkonin që territoret jugore të pretenduara prej saj të ishin pjesë e shtetit shqiptar. Por, ajo nuk kishte as fuqi që ta pengonte shpalljen e saj, sepse Ismail Qemali kishte siguruar mbështetje ndërkombëtare të Fuqive të Trepalëshit. Në një situatë të tillë, qeveria greke u përpoq ta vononte shpallje e Pavarësisë, të paktën deri në mbajtjen e Konferencës së Londrës. Në mungesë të reagimit shqiptar, Austro-Hungaria dhe Italia do ta kishin më të vështirë të mbronin çështjen shqiptare dhe fqinjët më të lehtë për të legjitimuar pretendimet e tyre në viset shqiptare.

Një politikë e tillë u shpreh së pari në mos heqjen e bllokadës së Vlorës, duke e detyruar anijen austriake me Ismail Qemalin në bord, të drejtohet për në Durrës. Së dyti në atmosferën penguese që atij ju rezervua në Durrës nga mitropoliti i qytetit, Jakovi. Qëndrimet e tij si ndaj shpalljes së pavarësisë ashtu edhe ndaj pushtimit të qytetit nga ushtria serbe, ishin në mbështetje të politikës greke. Zbritja e ushtrisë serbe në Durrës, shikohej nga shtypi grek, si faktor frenues i aktit të Shpalljes së Pavarësisë<sup>44</sup>. I cilësuar nga një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve si “nacionalist anadollak”, Jakovi, në marrëveshje me autoritetet osmane të qytetit, doli në mbrojtje të sistemit të vjetër osman duke kundërshtuar hapur ngritjen e flamurit shqiptar në Durrës nga Ismail Qemalin.<sup>45</sup> Meshat e mbajtura prej tij, kishin lënë mënjanë punët fetare për t’i përkushtuar punëve politike. Në to, Ismail Qemali cilësohej të ishte një fanatik mysliman e aventurier, dhe Pavarësia e Shqipërisë si

---

<sup>44</sup> Shkëlzen Raça, *Shpallja e Pavarësisë dhe shtypi grek*. Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore kushtuar 90-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë, Tiranë, 27 nëntor 2002 (e pabotuar).

<sup>45</sup> *AQSh*, Fondi 20, dos. 3, fl. 24. Kujtime të Mehmet Ndroqit, sekretarit të komandantit të xhandarmërisë së Durrësit, Hamit Toptanit; *AQSh*, Fondi 1501/3, dos. 33, fl. 1-2. Telegram i zv. konsullit italian në Durrës për Ministrinë e Jashtme në Romë, dt, 28 nëntor 1912.

prishëse e harmonisë mes të krishterëve e myslimanëve<sup>46</sup>. Me asistencën edhe të konsullatën greke në Durrës, ortodoksëve të qytetit iu ishte bërë thirrje për t'i mbajtur shpresat tek pushtimi i shpejtë i qytetit nga forcat serbe. Ndërkohë me anë fletushkash, tregtarëve ortodoksë durrsakë u bëhej thirrje, ta shihnin me kënaqësi pushtimin e qytetit nga serbët, sepse komanda serbe do t'u jepte atyre përkrahje<sup>47</sup>. Jakovi së bashku me një kryqëzor grek ishte nga pritësit e parë të serbëve në Durrës<sup>48</sup>. Parullat e hedhura nga besnikët e tij shprehnin hapur kënaqësinë e pushtimit të qytetit nga serbët.

Në fakt, Greqia, megjithëse e dëshiroi vonesën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, pa dashjen e saj ndikoi në të kundërtën. Nga një material i gjetur në Arkivin Qendror të Shtetit, në fondin e Ismail Qemalit, Kuvendi i shqiptarëve i cili do të shpallte pavarësinë, pritej të mbahej ditën e hënën, më 2 dhjetor 1912.<sup>49</sup> Mbajtja e tij në atë datë sipas materialit në fjalë, lidhej me ardhjen e Myfid Libohovës nga Janina, ku ai kishte shkuar të takonte komandantin e ushtrisë osmane, Esat pashë Janinën dhe kishte arritur të shmangte arrestimin e Ismail Qemalit nga forcat osmane<sup>50</sup>. Duke tentuar të priste lidhjen telegrafike nënujore, Vlorë-Otranto, e cila pretendohet se përdorej nga organet osmane për të transportuar lajme të rëndësishme ushtarake<sup>51</sup>, Greqia i detyroi shqiptarët të shpejtonin mbajtjen e Kongresit, pa pritur ardhjen e Myfit Libohovës dhe të një pjese të delegatëve. Të vënë në dijeni mbi përpjekjen greke, përfundimi me sukses i të cilës shkëpute edhe lidhjen e Vlorës me botën e jashtme dhe pengonte njoftimin e shpalljes së pavarësisë, delegatët shqiptarë të mbledhur në Vlorë shpallën pavarësinë e Shqipërisë, disa ditë përpara, të enjten më 28 nëntor 1912<sup>52</sup>.

Po në të njëjtën ditë, Ismail Qemali tashmë me atributet e kryetarit të qeverisë së parë shqiptare, vuri në dijeni mbi zhvillimet shqiptare si Fuqitë e Mëdha, ashtu dhe të katër qeveritë e Aleatëve Ballkanike. Në letrën dërguar bashkërisht Ministrive të Jashtme të Sofjes, Beogradit, Athinës dhe

<sup>46</sup> Hajredin Isufi, *Feja dhe flamuri: Dom Nikoll Kaçorri*, Pegi, Tiranë, 2008, f. 326.

<sup>47</sup> *Po aty*, f. 342.

<sup>48</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj. 22-15-1563. Telegram i konsullit austriak në Durrës për ambasadorin e Austro Hungarisë në Stamboll, Durrës, 3 dhjetor 1912.

<sup>49</sup> *AQSh*, Fondi 20, dos. 3, fl. 33. Kujtime të Mehmet Ndroqit, sekretarit të Hamit Toptanit.

<sup>50</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj. 22-8-870. Njoftim i konsullit austriak në Vlorë për Ministrinë e Jashtme, Vlorë, 3 dhjetor 1912; *AQSh*, Fondi 20, dos. 3, fl. 33.

<sup>51</sup> *HHSA* në *AIH*, Vj. Raport nga Roma për Bertoldin, Romë, 10 shkurt 1913.

<sup>52</sup> *AQSh*, Fondi 20, dos. 3, fl. 33.

Cetinës, ai përveçse njoftonte shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e një qeverie të përkohshme shqiptare, shprehte edhe dëshirën e shqiptarëve për të jetuar në paqe dhe harmoni me shtetet ballkanike<sup>53</sup>. Madje, çështja shtrohej edhe më gjerë, sepse kërkohesh edhe njohja e qeverisë shqiptare, pushimi i veprimeve ushtarake në tokën shqiptare madje edhe kthimi e të gjitha viseve shqiptare të pushtuara nga ushtritë aleate<sup>54</sup>. Në këtë mënyrë, Ismail Qemali, tentoi të hapte një etapë të re në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe fqinjëve të saj, duke shpresuar në bashkëpunimin dhe besimin reciprok.

*S u m m a r y*

ALBANIA AND GREECE DURING THE FIRST BALKAN WAR  
(OCTOBER – NOVEMBER 1912)

Greece in difference with Serbia it was not very clear in its stand about the future of the Albanian territories. In order to have good and stable relations with Serbia and a borderline with Bulgaria that would justify its own claims it was now ready to sacrifice the existence of Albania. In the beginning of November 1912 the Greek government agreed to divide the Albanian territories between Greece and Serbia and to support the Serbian claims for an exit to the sea from Lezha to Durrës. In the general context of war operations, the Albanian territories were considered by Greece as ottoman territories. In this way started the military operations of Greece for the invasion of the Albanian territories.

The outbreak and the future of the war created concerns and made consciousness the Albanians who had started the preparations to react. Ismail Qemali rightly was thinking that the war would bring the enlargement of the Slav front. In order to balance the strengthening of the Slav front he considered Rumania, Albania and Greece as members of second front in the Balkans. After he obtained the support of Rumania and of the Triple Alliance for the independence of Albania, he made a meeting with the Greek ambassador in Vienna. Regardless of the reciprocal sympathy that Greece and Ismail Qemali continuously had for each other, the Greek government was not inclined to support the independence of Albania. By not being able to prevent the declaration of independence, the Greek government tried to delay it, at least until when the London Conference was going to be held. With all the delays that were encountered in Durrës, the Albanians declared the independence of Albania in 28 November 1912 in Vlora. In the same day, yet with the attributes of the head of the first Albanian government, Ismail Qemali informed about the Albanian developments the Great Powers as well as the governments of the Balkan allies. In this manner, he attempted to start a new epoch of relations between Albania and its neighbors, hoping for collaboration and reciprocal trust.

---

<sup>53</sup> *AQSh*, Fondi 145, dos. II-15, fl. 4. Letër e kryetarit të qeverisë shqiptare, Ismail Qemali derguar Ministrive të Punëve të Jashtme të Sofjes, Beogradit, Athinës dhe Cetinës, Vlorë, 28 nëntor 1912.

<sup>54</sup> *Po aty*; Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, 8 Nëntori, Tiranë, 1978, f. 128.